



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR
TIRANE



Nr. 14214 AKTI

Nr. 7667 VENDIMI

VENDIM
" NË EMËR TË REPUBLIKËS "

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej:

GJYQTARE: ANILA CAPO - ZERE

Asistuar nga sekretare gjyqësore Fabjola Muhameti sot me dt. 19.07.2012 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile me Nr. 14214 akti që i përket:

KERKUES:

File Gashi, e bija e Ahmetit dhe Sulltanës, dtl 21.05.1947 lindur dhe banuese në Tiranë Rr. "Siri Kodra" nr. 88/1 identifikuar me numer Karte Identiteti 024512511

OBJEKTI:

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë për të ndjerin djalin tim Gentian Zguri.

BAZA LIGJORE:

Neni 361, 348, 360 të K. Civil.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat shkresore, dëgjoi pretendimet e kërkuësës e cila kërkoi pranimin e kërkesës.

V Ë R E N

Se kërkuësja File Gashi i është drejtuar gjykates me kërkesë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit Gentian Zguri.

Nga hetimi gjyqësor rezulton se Gentian Zguri ka lindur me 30.04.1976 dhe ka vdekur në dt. 12.11.2011 dhe nga certifikata e gjendjes civile rezulton me gjendjen civile beqar.

Me vdekjen e tij trashëgimtare ligjor të radhës së dytë rezulton të jetë vetëm nëna e tij File Gashi, pasi babai i të ndjerit Gentian Zguri ka nderruar jetë me 22.01.1997.

Sa me siper cituam, provohen nga:

1. Certifikate vdekje e Gentian Zguri me Nr.serial 002403265 me 13.06.2012 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake nr. 8, Tirane.
2. Certifikate vdekje e Gentian Zguri me Nr.serial 002981672, date 19.07.2012 leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake nr. 8, Tirane.
3. Certifikate familjare me Nr.serial 002403266 e dates 13.06.2012, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake nr. 8, Tirane.
4. Certifikate familjare me Nr.serial 002403298 e dates 13.06.2012, leshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Bashkiake nr. 8, Tirane.
5. Certifikate personale e File Gashi me nr. Serial 002061663 e dt. 13.06.2012 Njesia Bashkiake nr. 8, Tirane.
6. Certifikate personale e Ilir Gashi me nr. Serial 002403267 e dt. 13.06.2012 Njesia Bashkiake nr. 08, Tirane.

Pasi u renditen faktet e mesiperme, gjykata ne baze te nenit 318 te Kodit Civil, i cili thote se "trashegimia çelet ne kohën kur vdes trashëgimlënesi dhe ne vendin ku ka patur banimin e tij te fundit.... Ajo rregullohet sipas ligjit te kohes kur eshte çelur", percakton se ne rastin tone koha kur celet trashëgimia eshte data e vdekjes se Gentian Zguri dhe pikerisht dt. 12.11.2011. Prandaj, ligji qe do te parashikoje rregullimin ligjor per çeljen e trashëgimise eshte K.Civil ne fuqi.

Ne baze te nenit 317 te K.Civil te siperpermendur "trashegimia me ligj zbatohet kur trashëgimlënesi nuk ka bere testament...". Ne rastin tone per te leshuar deshmine e trashëgimise, duke qene se trashëgimlënesi Gentian Zguri nuk rezulton te kete lene testamet do te zbatohen dispozitat ligjore te K.Civil qe rregullojne trashëgimine ligjore.

Duhet theksuar se qe te perfitoje trashëgimtari nga pasuria trashëgimore duhet se pari qe ai te kete zotesi trashëgimore dhe se dyti te beje pjese ne radhen e trashëgimtareve ligjor ne baze te ligjit iu takon pasuria trashëgimore.

Persa i perket te pares, zotesi per te trashëguar ne baze te nenit 320 te K.Civil "ka personi qe ne kohe e celjes se trashëgimise, pra kur ka vdekur trashëgimlënesi, eshte gjalle...."

Persa i perket te dytes, neni 360 i K.Civil thote se "trashëgimtare ligjore jane femijet, femijet e femijeve, bashkeshorti, prinderit,.... Keta thirren ne trashëgimi sipas radhes te caktuar ne kete Kod" ; ndersa neni 361/1 i K.Civil thote se "Ne radhe te pare thirren ne trashëgim femijet dhe bashkeshorti i afte ose i paaftë per pune, duke trashëguar secili ne pjese te barabarta."

Nga interpretimi i dispozitave te mesiperme ligjore del se kur çelet trashëgimia ligjore ne radhe te pare perfitojne bashkeshorti dhe femijet e trashëgimlënesit ne pjese te barabarta, te cilet jane gjalle ne çastin e celjes se trashëgimise.

Persa me siper ne rastin tone trashëgimtare e trashëgimlënesit Gentian Zguri (Gashi) eshte nena e tij File Gashi.

Shpenzimet gjyqesore ne baze te nenit 102 e ne vijim te K.Pr.Civile jane ne ngarkim te kerkueses

PER KETO ARESYE:

Ne baze te neneve 348, 317, 360, 361 te K.C; dhe neneve 388, 306 e ne vijim te K.Pr.Civile, gjykata


V E N D O S I:

- Pranimin e kërkesës.
- Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin Gentian Zguri e cila celet ne daten e vdekjes se tij me dt. 12.11.2011
- Percaktimin si trashëgimtare ligjorë të rradhës së dyte nenen e tij File Gashi
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kerkuesit.
- Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes.

U shpall sot ne Tirane me dt. 19.07.2012

SEKRETARE

FABJOLA MUHAMETI



Shpenzimet gjyqesore
Takse pulle 800 leke



GJYQTARE


ANILA CAPO - ZERE




Vendimi mori forme te prere pas:
nuk u ankimua me dt 03.08.2012
Tirane me dt 06.08.2012

K / SEKRETARE

Mimoza CENAJ (LULAJ)



KANCELAR
Eudin BAQLI



PULLE TARIFE



R.SHQIPERISE

PULLE TARIFE



R.SHQIPERISE

PULLE TARIFE



R.SHQIPERISE

PULLE TARIFE



R.SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 5919 Rep.

Tirane, me 22.05.2013

VERTETIM
NJESIA ME ORIGJINALIN

Unë, Noter Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tirane, me seli në Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, Tirane, **vërtetoj se njësia bashkëlidhur është kopje e njëjtte me dokumentin original.**

Dokumenti është Vendim nr. 7667 datë 19.07.2012, leshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

Dokumenti u paraqit nga Znj. Ana Goro, e njohur personalisht prej meje.

Vërtetimi i dokumentit u bë në bazë të nenit 56, të ligjit nr. 7859, datë 01.06.1994 "Për Noterinë", (i ndryshuar) dhe pikave 3,4,7 të Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005.

NOTER
JULIAN ZHELEGU

